UDHËZIM
Nr.43, datë 31.10.2011

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.38, DATË 23.9.2011 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.627, datë 31.8.2011 "Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 "Për kryerjen nga "Posta Shqiptare" sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror",

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 7 të udhëzimit nr.38, datë 23.9.2011 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012", shtohen pikat 7.1, 7.2 dhe 7.3, si më poshtë:

"7.1 Aplikimi i kandidatëve që do t'u nënshtrohen konkurseve të pranimit, në programin e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), të zhvillohet nga data 1.11.2011 deri në datën 4.11.2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të UST-së. Konkursi i pranimit zhvillohet më datë 5.11.2011.

7.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës të shpallë dhe të afishojë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 7.11.2011, të ndara sipas programeve të studimit përkatës.

7.3 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 8.11.2011 deri në datën 11.11.2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.".

2. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj